



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport



Plani i punës për vitin 2026

Mars, 2026

Parathënie

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Mitrovicës përbëhet nga tre sektorë: Sektori i Kulturës, i Rinisë dhe i Sport, që në fakt përbëjnë edhe kompleksitetin e punës së kësaj drejtorie. Institucionet vartëse të saj janë: Qendra e Kulturës, Teatri i Qytetit, Ansambli i Qytetit, Biblioteka Komunale “Latif Berisha”, Muzeu i Qytetit, Palestra e Sporteve “Minatori”, Galeria e Arteve si dhe Salla e Sporteve të vogla “Fatime Xhaka” (Galeria e Arteve nuk janë funksionale, e palestra e sporteve Fatime Xhaka i është dhënë në shfrytëzim organiztës rinore Futja Ngjyrë, qendra inovative Futja Zanat). Personeli i Drejtorisë përbëhet nga gjithsejtë 42 zyrtarë, si dhe 20 në teatër, të cilët punojnë në departamentet respektive, të ndarë sipas organo-gramëve përkatëse. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Mitrovicës ka paraparë ngritje të vazhdueshme të kapaciteteve të saj në fusha të ndryshme.

DKRS, në bashkëpunim me institucionet vartëse, ka planifikuar qëllimet dhe objektivat e saj për këtë vit. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Mitrovicës, duke analizuar në hollësi buxhetin e planifikuar për këtë vit dhe duke pasur parasysh resurset njerëzore, ka planifikuar që gjatë këtij viti kalendarik të mbështesë në forma të ndryshme ngritjen e kapaciteteve në sektorët e saj, gjithmonë në bazë të ligjeve që rregullojnë natyrën e punëve të DKRS dhe menaxhimit komunal. DKRS do të jetë përgjegjëse dhe aktive në punën e saj, në mënyrë që objektivat e parashikuara të arrihen dhe të respektohen aktivitetet tradicionale të sektorëve përkatës. Të nxisë investitorët dhe të kërkojë fonde shtesë; -

DKRS edhe gjatë vitit 2026 përvec zbatimit të rregullores për subvencionimin e OJQve, do ta zbatojë Rregullorën Komunale për Subvencionimin e Individëve dhe Strategjinë për Kulturë si dhe do ta organizojë hartimin e Planit të Veprimit Rinor Lokal si dhe do të përditësojë kalendarin kulturor në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile.

DKRS gjatë vitit 2026 ne planifikojmë që ti plotësojë pozitën e lira si në Sektorët e vet po ashtu edhe tek Institucionet vartëse.

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit është përgjegjëse për performancën e detyrave dhe përgjegjësi si në vijim.

PS: Në këtë plan nuk përfshihet Teatri, i cili ka publikuar ndaras planin e punës.

- Hartimin e planit për mbështetjen kulturore, sportive dhe rinore;
- Udhëheqja me resurset lokale kulturore, rinore dhe sportive;
- Udhëheqja me Teatrin, Bibliotekën e Qytetit, Muzeun e Qytetit, Qendrën e Kulturës, Palestrën e sporteve dhe hapësirat tjera përcjellëse;
- Rishikimi i strategjisë për kulturë
- Organizon dhe shënon data me rëndësi historike kur kërkohet;
- Organizon debate për zhvillim dhe avancim të kulturës, rinisë dhe sportit;
- Grumbullon shënime faktike mbi të arriturat në kulturë, rini dhe sport;
- Bashkëpunon ngushtë dhe të raporton për punën e vet Kryetarit të Komunës;
- Bashkëpunon me nivelin qendror nga fushë veprimtaria përkatëse dhe këshilltarët nga këto fusha;
- Bënë regjistrimin e grupeve, klubeve, ansambleve etj;
- Mbështetja e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive;
- Bashkëpunon me qytete tjera, për të mundësuar një integrim të mirëfilltë dhe këmbim përvojash si dhe me OJQ, e organizata të tjera vendore e ndërkombëtare;
- Përkrahë dhe ndihmon asociacione, klub dhe shoqata në aktivitetet e tyre;
- Përkrah, mbështet dhe mbikëqyrë punën dhe funksionimin e Qendrës Rinore në përputhje me ligjin;
- Ofron institucionet e veta në shërbim të përgjithshëm të qytetarëve (me veprimtaritë primare që kryejnë ato, por në raste emergjente dhe veprimtari të tjera);
- Të nxisë investitorët dhe të kërkojë fonde shtesë;
- Organizon anketa, seminare e trajnime të ndryshme, kyçe të të rinjve kosovarë në aktualitete rinore, evropiane e botërore;
- Ushtron edhe kompetenca tjera që do t'i përcaktohen me ligj ose që delegohen nga pushteti qendror.

Objektivat e përgjithshme të DKRS-së:

- ❖ Përmirësimi i infrastrukturës së brendshme të institucioneve vartëse të Drejtorisë;
- ❖ Ngritja e nivelit të përgjegjësisë së monitorimit-raportimit për të gjitha projektet;
- ❖ Avancimi i bashkëpunimit me OJQ, klube sportive dhe akterë tjerë të bashkëpunimit;
- ❖ Subvencionimi i klubeve sportive sipas kriterëve;
- ❖ Subvencionimi i OJQ-ve, shoqatave dhe grupeve tjera të interesit për projektet me interes për qytetin;
- ❖ Subvencionimi dhe përkrahja e talentëve në sport e kulturë
- ❖ Përkrahja e nismave për ngritjen e vetëdijes së qytetarëve për rëndësinë e kultivimit të kulturës, ruajtjes së shëndetit, bashkëpunimit me të rinjtë e rajonit, etj;
- ❖ Respektimi i kalendarit të festave të vendit, sipas një rrjedhe të zakonshme;
- ❖ Fuqizimi i stafit të DKRS-së dhe institucioneve vartëse
- ❖ Katalogu i objekteve me vlera kulturore dhe historike
- ❖ Monografi e dëshmorëve në Komunën e Mitrovicës
- ❖ Identifikimi, mbledhja dhe ruajtja e dëshmimeve për luftën e fundit (rrënoja, mbetje municionesh, 3roba, shkrime, video, rrëfime...)

Duke marrë për bazë ligjet që rregullojnë qeverisjen lokale, aktet nënligjore dhe rregulloret e Kuvendit të Komunës së Mitrovicës, DKRS zotohet që do t'i përmbushë në përpikëri planifikimet e veta për këtë vit. DKRS do të bashkëpunoj ngushtë me aktetë relevante, me partnerë si dhe me vet komunitetin.

SEKTORI I KULTURËS

SEKTORI I KULTURËS

Duke u mbështetur në politikat afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të zhvillimit të kulturës, si dhe në planet e punës të institucioneve vartëse të kulturës, DKRS – Sektori i Kulturës, për vitin 2026 do t'i shpall dy thirrje Publike për financim të projekteve të OJQ-ve.

1. Nxitja e krijimtarisë artistike

- ❖ Mbështetje talentëve të rinj në fusha kulturore
- ❖ Pjesëmarrja e trupave artistike të Mitrovicës në festivale të ndryshme në vend dhe jashtë vendit
- ❖ Plani komunal për trashëgiminë kulturore.

2. Aktivitetet kulturore tradicionale

- ❖ Ditët e mërgimtarëve – aktivitet i pasur dymujor me aktivitete të larmishme në bashkëpunim me organizata e klube kulturore e sportive.
- ❖ Mitrovica Art Colony 2026;
- ❖ Ekspozita e Nëntorit dhe dhënia e Çmimit “Kadri Kadriu”;

3. Kremtimi i festave kombëtare dhe ndërkombëtare

- ❖ Kremtimi i 17 Shkurtit – Ditës së Pavarësisë;
- ❖ Kremtimi i 6 Qershorit – Ditës së Dëshmorëve të Mitrovicës;
- ❖ Kremtimi i 28 Nëntorit – Ditës së Flamurit;
- ❖ Kremtimi i festave tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe shënimi i përvjetorëve të rëndësishëm, sipas kalendarit kulturore të përpiluar nga Sektori i Kulturës në bashkëpunim me oragnizatat e shoqërisë civile dhe aktetë të ndryshëm relevante.
- ❖ Sheshi Festiv (aktivitet një mujor me shtëpiza dhe koncerte të ndryshme)

4. Organizimi i koncerteve në muajin korrik

- ❖ Ditët e Rock-ut në Mitrovicë

- ❖ Ditët e Diasporës.

5. Organizimi i festivaleve tradicionale dhe festivaleve të reja

- ❖ Festivali i Arizaneve dhe ushqimeve tradicionale,
- ❖ Festivali Tradicional i Komedisë,
- ❖ Festivali i Këngës së Fëmijëve "Cicërimat buzë Ibrit";
- ❖ Festivali GlobalMusica,
- ❖ Festivali i përvitshëm "Green Fest";
- ❖ Festivali Mitrovica Guitar Days,
- ❖ Festivali Mitrovica International Jazz festival Days,

7. Organizimi i ngjarjeve të vecanta për nder të personaliteteve të vecanta

Qendra e Kulturës "Rexhep Mitrovica"

Në Qendrën e Kulturës "Rexhep Mitrovica", gjatë vitit 2026 do të organizohen këto aktivitete. Organizimin e aktiviteteve të ndryshme kulturore në bashkëpunim me institucionet tjera të kulturës dhe organizata të ndryshme

- Në vitin 2026, planifikohet të funksionalizohen salla e konferencave si dhe salla e leximit. Rifunksionalizimi i këtyre hapësirave do të ndikonte në avansimin e jetës kulturo-artistike në qytetin e Mitrovicës.
 - Për rifunksionalizimin e këtyre sallave është e domosdoshme gjetja e mundësive për investime kapitale në rreullimin e tyre si dhe në kompletimin me inventar dhe paisje që janë të nevojshme për këto salla.
 - Në planin e brendshëm do të angazhohemi në mbarëvajtjen e punëve dhe ngritjen e performancës së stafit, si dhe shtimin e aktiviteteve kulturo-artistike
 - Shtimi i stafit, veçmas pozita e Mirëmbajtësit të Nxehmjeve Qendrore, si dhe punëve të ngjashme, teknike që do të ndikojnë në një ambient më të mirë për aktivitetet dhe organizimet që do të zhvillohen në Qendrën e Kulturës. Poashtu edhe të dy Pastrueseve në menyrë që në hapsirat e Qendrës së Kulturës të mirëmbahet pastertija dhe higjena në objekt. Kjo ka qenë kërkesë e meherëshme sepse hiç dihet objekti nuk ka pastruese prej vitesh.
 - Rregullimi i rrjetit elektrik brenda objektit si dhe shtimi i masave të sigurisë rreth objekti. Po ashtu edhe ndriqimi dhe rregullimi i hyrjes në objekt.
 - Ridizajnimi i mureve në hollin e Qendrës së Kulturës dhe mundësia e rifunksionalizimit të Kinemasë brenda objektit.
 - Shenjzimin në institucion - Vendosja e tabelës në hyrje të objektit me mbishkrimin Qendra e Kulturës "Rexhep Mitrovica", si dhe vensoja e flamujve shtetëror dhe kombëtar në oborrin e objektit.
 - Riaplikimi i pagesave për çdo aktivitet, si dhe mundësia e ndryshim plotësimit të Rregullores Komunale për Pagesa
- Për realizimin e këtij plani, nevojitet përkrahja e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Mitrovicës si dhe mbështetja e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Bibloteka e qytetit “Latif Berisha”

Përveç regjistrimit, përpunimit, inventarizimit dhe katalogimit të librave dhe sistemimin e tyre nëpër sektore përkatëse për nevojat e lexuesve; rritjes së numrit të lexuesve; vazhdimin të kontakteve me bibliotekat e shkollave fillore, të mesme dhe asaj të fakultetit në Mitrovicë dhe atyre në Kosovë si dhe në Shqipëri; pasurimit të fondit librar Biblioteka Komunale “Latif Berisha”, ndër të tjera ka në plan t’i realizojë dhe këto aktivitete:

AKTIVITETET

- 17 shkurti - Dita e Pavarsisë së Kosovës
- 7 mars - Dita e mësuesit
- 24 mars – Dita Bibliotekës
- Trajnimi i stafit në kuadër të BKK-së
- Përkrahja nga DKRS, për pasurimi i fondit librar, me tituj të rinj dhe aktual në bibliotekë qendrore; në degë Tunel i parë dhe biblioteka degë në Kçiq
- Java e Bibliotekës në Kosovë – prill
- 23 prill – Dita ndërkombtare e librit
- 1 Qershori – Dita Ndërkombtare e Fëmijëve
- Vizit Panairit të librit në Prishtinë – Qershor (Pasarimi i bibliotekës me libra të rinj)
- Biblioteka e hapur për vizitë - për Diasporën
- Dita e poetit – Orë letrare
- Kompletimi i skedarëve

Muzeu i Qytetit

Objektivat

Muzeu i Qytetit të Mitrovicës, është institucion i trashëgimisë kulturore, njëherit institucion edukativ dhe rekreativ që ka për qëllim që në kuadër të vitit 2026, të ketë fokus në këto objektivat:

1. Promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore shpirtërore dhe materiale të qytetit të Mitrovicës;
2. Mbledhjen e artefakteve e materialeve muzeale;
3. Mbledhje të memories kolektive të qytetit si dhe 2ashkëpu të qytetit;
4. Ekspozimit të materialve muzeore;
5. Ngritje të kapaciteteve të stafit përmes trajnimeve e vizitave studimore;
6. Konservimin dhe sistemimin e arkivave muzeore;
7. Ngritje të vizibilitetit dhe numrit të vizitorëve.
8. Të zhvilloj dhe forcoj partneritete me institucione dhe subjekte relevante për rritjen e kapaciteteve të qëndrueshmërisë;

Gjithë veprimtaria muzeale do të bazohet në qasje interaktive gjithëpërfshirëse si dhe të zhvillimit të qëndrueshëm me vizionin Muze i Mitrovicës/ Muze i të Gjithëve.

Për të arritur këto objektiva Muzeu i Qytetit të Mitrovicës parasheh disa ekspozita dhe aktivitete të ndryshme.

1.Nevoja për zhvillim institucional dhe funksionim të Muzeut të Mitrovicës

Këto objektiva janë të domosdoshme për zhvillimin e qëndrueshëm dhe funksional të Muzeut të Mitrovicës. Sigurimi i Selisë së Përhershme dhe miratimi i Statutit krijojnë bazën ligjore dhe institucionale për punën e muzeut, ndërsa Hartimi i Planit të Menaxhimit dhe i Planit Edukativ mundësojnë organizimin profesional të koleksioneve, menaxhimin strategjik të hapësirave muzeale dhe angazhimin aktiv të komunitetit. Bashkërisht, këto hapa kontribuojnë në rritjen e vizibilitetit, pjesëmarrjes komunitare dhe cilësisë së shërbimeve edukative dhe kulturore që muzeu ofron për qytetarët.

Objektivat:

- Propozimi dhe sigurimi i aprovimit të Selisë së Përhershme të Muzeut përmes DKRS tek Kryetari, dhe më pas miratimi nga Kuvendi Komunal.
- Hartimi i Planit të Menaxhimit për zhvillimin institucional dhe koleksionin muzeal, duke përfshirë rekonceptimin e hapësirës së ish-armatës për t'u kthyer në muze të përhershëm.
- Hartimi i Programit Edukativ të Muzeut të Mitrovicës në bashkëpunim me komunitetin, duke përfshirë mësimdhënës, OJQ, dhe grupmosha të ndryshme, me qëllim të zhvillimit të programeve gjithëpërfshirëse dhe të përshtatura me nevojat komunitare.
- Hartimi dhe miratimi i Statutit të Muzeut të Mitrovicës si bazë ligjore dhe funksionale për punën dhe menaxhimin institucional.

Pritshmëritë:

- Sigurimi i bazës ligjore dhe administrative për vendosjen e selisë së përhershme të muzeut dhe për funksionimin e tij institucional.
- Përforsimi i strukturës profesionale të menaxhimit të muzeut dhe planifikimi strategjik për zhvillim institucional dhe kurim të koleksioneve.
- Rritja e pjesëmarrjes aktive të komunitetit dhe përmirësimi i programit edukativ për t'u përshtatur më mirë nevojave të ndryshme komunitare.
- Sigurimi i kuadrit ligjor dhe rregullativ për funksionimin efektiv të muzeut përmes Statutit të miratuar.

Rezultatet:

- Miratimi zyrtar i Selisë së Përhershme të Muzeut nga Kuvendi Komunal.
- Hartimi i Planit të Menaxhimit dhe i planit të rekonceptimit të hapësirës muzeale, si dokument bazë për fillimin e procesit të transformimit të hapësirës së ish-armatës në muze të përhershëm.
- Propozimi dhe konsolidimi i Programit Edukativ të përmirësuar, duke reflektuar idetë dhe nevojat e komunitetit dhe duke ofruar baza për projekte edukative gjithëpërfshirëse në të ardhmen.
- Hartimi dhe miratimi i Statutit të Muzeut, duke siguruar kuadër ligjor, rregullativ dhe funksional për menaxhimin dhe zhvillimin e tij.

Ekspozita Vegëza

Në kuadër të Programit Edukativ të Grupit të Thurjes “Vegëza”, do të hapet ekspozita “**Vegëza**”, e cila do të prezantojë punimet dore të grave të grupit, duke theksuar rëndësinë e trashëgimisë kulturore dhe aftësive artizanale tradicionale. Përveç ekspozimit fizik, do të vazhdojë digjitalizimi i punimeve të cejzit, duke siguruar ruajtjen, dokumentimin dhe promovimin e tyre në format dixhital për përdorim edukativ dhe kulturor.

Objektivat:

- Promovimi i trashëgimisë kulturore dhe aftësive artizanale të grave përmes ekspozitës dhe materialeve dixhitale;
- Dokumentimi dhe digjitalizimi i punimeve të cejzit për ruajtje dhe përdorim edukativ;
- Inkurajimi i pjesëmarrjes aktive të komunitetit dhe grupit të grave në zhvillimin e programit edukativ;
- Përforsimi i lidhjes ndërmjet traditës dhe teknologjisë për qëllime edukative dhe prezantimi publik.

Rezultatet:

- Hapja e ekspozitës “Vegëza” me punime dore të grave të grupit;
- Digjitalizimi i koleksionit të cejzit, i cili do të jetë i aksesueshëm për përdorime edukative dhe promovuese;
- Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për trashëgiminë kulturore dhe aftësitë artizanale të grave;
- Krijimi i bazës për projekte të mëtejshme edukative dhe bashkëpunime me komunitetin.

Ekspozita e Enëve – 2026

Muzeu i Mitrovicës prezanton koleksionin unik të enëve etnologjike, disa shekullore, që nuk janë ekspozuar më parë si koleksion i veçantë. Ekspozita tregon vlerën historike dhe artistike të enëve dhe ofron një përvojë vizuale dhe edukative për vizitorët, duke përfshirë pastrimin e objekteve, përgatitjen e sallave, vendosjen e vitrinave dhe ndriçimin, hartimin e dizajnit të hapësirës dhe hapjen zyrtare për publikun.

Objektivat:

- Prezantimi i koleksionit të veçantë të enëve etnologjike, disa shekullore, që nuk janë ekspozuar kurrë si koleksion i vetëm për publikun;
- Pastrimi, përgatitja dhe konservimi i objekteve për ekspozim;
- Hartimi i dizajnit të hapësirës dhe i rrjedhës së ekspozitës;
- Përgatitja e sallave (lyerja), blerja dhe vendosja e vitrinave, si dhe sistemimi i ndriçimit dhe mburojave për ekspozim;
- Hapja e ekspozitës dhe promovimi për vizitorët.

Pritshmëritë:

- Prezentim profesional i koleksionit dhe nxjerrja në pah e vlerës historike dhe artistike të enëve;
- Përforsim i vizibilitetit të muzeut dhe i qasjes gjithëpërfshirëse për publikun;
- Rritja e ndërgjegjësimit të vizitorëve mbi trashëgiminë kulturore dhe rëndësinë e ruajtjes së koleksioneve muzeale;
- Sigurimi i një përvoje vizuale dhe edukative cilësore për publiku dhe komunitetin.

Programi Edukativ i Muzeut – 2026

Programi Edukativ i Muzeut të Mitrovicës synon të bëjë muzeun një hapësirë gjithëpërfshirëse për komunitetin, duke integruar traditën, historinë dhe trashëgiminë kulturore në aktivitete interaktive dhe edukative. Ai përfshin një gamë aktivitete të ndryshme:

- **Grupi i Thurjes** – aktivitet krijues dhe edukativ për të gjitha grupmoshat, që rikthen artin e thurjes tradicionale dhe bashkon breza të ndryshëm;
- **Punëtori vizatimi për fëmijë** – për nxënësit, për të nxitur kreativitetin dhe njohuritë mbi trashëgiminë kulturore;
- **Punëtori me argjile dhe fije tekstili** – për fëmijë dhe të rritur, në bashkëpunim me shkolla lokale, për zhvillimin e aftësive artistike;
- **Program me të rinj nga komunitete të marginalizuara** – hapësirë për përfshirje aktive dhe zhvillim të aftësive artistike për grupet me nevojë të veçanta;
- **Programi edukativ “Muzeu Lëvizës”** – sjell aktivitetet e muzeut tek fëmijët e zonave rurale dhe përfshinë bashkëpunime me shkolla dhe qendra burimore lokale, duke përfshirë pjesëmarrës me aftësi të kufizuara.

Objektivat:

- Hartimi dhe miratimi i një programi gjithëpërfshirës edukativ për të gjitha grupmoshat;
- Inkurajimi i pjesëmarrjes së komunitetit në aktivitete muzeale dhe projekte edukative;
- Integrimi i ekspozitave, hulumtimeve dhe koleksioneve muzeale në aktivitete mësimore dhe kreative;
- Forcimi i bashkëpunimit me shkolla, OJQ dhe grupe komunitare për zhvillimin e programeve të qëndrueshme.

Pritshmëritë:

- Krijimi i pjesëmarrjes aktive të komunitetit dhe vizitorëve në aktivitetet muzeale;
- Përmirësimi i cilësisë së programeve edukative dhe adaptimi i tyre sipas nevojave të ndryshme komunitare;
- Bashkëpunim më i ngushtë me shkolla, ekspertë dhe organizata lokale;
- Përdorimi i metodave interaktive për mësimdhënie dhe prezantim të trashëgimisë kulturore.

Puna dhe vazhdimi i sistemimit të arkivave muzeale

Puna në arkivat e Muzeut të Mitrovicës është një proces i vazhdueshëm për ruajtjen dhe dokumentimin e koleksioneve, sidomos të materialeve organike si tekstili dhe druri. Për konservim profesional dhe dokumentim të saktë, duhet të angazhohet një konservues profesional dhe bashkëpunohet me studentë të Etnologjisë, Arkeologjisë dhe Historisë, nën monitorimin e stafit të muzeut. Ky proces përfshinë inventarisim, pastrim bazik, digjitalizimin e sistemim adekuat të koleksioneve.

Objektivat:

- Konservimi dhe dokumentimi profesional i koleksioneve muzeale;
- Sistemimi dhe digjitalizimi i materialeve arkivore për përdorim edukativ dhe ekspozita;
- Përgatitja dhe promovimi i katalogut etnologjik;
- Bashkëpunimi me ekspertë dhe studentë për zhvillimin e kapaciteteve profesionale.

Aktivitetet:

- Angazhimi i konservuesit profesional;
- Bashkëpunimi me fakultete për studentë praktikantë;
- Blerja e materialeve për konservim;
- Konservimi, dokumentimi, digjitalizimi dhe sistemimi i koleksioneve;
- Përgatitja dhe promovimi i katalogut etnologjik.

Rezultatet e vitit 2026:

- Trajtimi dhe sistemimi i objekteve arkeologjike dhe etnologjike;
- Riparimi dhe pastrimi i veshjeve tradicionale dhe aksesorëve;
- Digjitalizimi i librave dhe artefakteve;
- Fillimi i dokumentimit digjital të punimeve të çejzit dhe gajtanit;
- Përgatitja dhe promovimi i katalogut etnologjik si burim edukativ dhe ekspozues.

1. Hulumtime Profesionale – 2026

Hulumtimi për Ekzod të Luftës 1999

Objektivat:

- Studimi i procesit të ekzodit dhe ndikimeve të tij në qytetin e Mitrovicës;
- Angazhimi i historianëve si konsulentë të jashtëm për korrektësi dhe standarde shkencore;
- Dokumentimi i burimeve arkivore, intervistave dhe materialeve të tjera historike;
- Përgatitja e materialeve për ekspozita, publikime dhe programe edukative.

Pritshmëritë:

- Mbledhje dhe sistemim i materialeve të besueshme dhe të verifikuara;
- Sigurimi i një qasje gjithëpërfshirëse dhe profesionalizëm në hulumtim;
- Përforsim i bazës shkencore të muzeut dhe pasurim i materialeve për publik dhe edukim;
- Rritja e vizibilitetit të punës muzeale në fushën e dokumentimit të historisë lokale.

Hulumtimi i Sportit Objektivat:

- Studimi i zhvillimit të sportit në qytetin e Mitrovicës dhe dokumentimi i historisë së tij;
- Përdorimi i ekspertizës së historianëve si konsulentë të jashtëm për korrektësi dhe standarde shkencore;
- Mbledhja dhe sistemimi i burimeve arkivore, fotografive dhe intervistave të lidhura me sportin;
- Përgatitja e materialeve edukative dhe ekspozitive mbi historinë e sportit në qytet.

Pritshmëritë:

- Sigurimi i hulumtimeve cilësore dhe shkencërisht të verifikuara;
- Forcimi i bashkëpunimit profesional me ekspertë dhe historianë;
- Rritja e qasjes gjithëpërfshirëse në dokumentimin e historisë sportive;
- Pasurimi i ekspozitave dhe programit edukativ të muzeut me materiale të reja dhe të verifikuara.

Rritja dhe përforsimi i partneriteteve

Muzeu i Qytetit të Mitrovicës ka vazhduar gjatë vitit 2026 zhvillimin e partneriteteve strategjike me institucione, OJQ dhe individë, duke e bërë veprimtarinë muzeale më të hapur, gjithëpërfshirëse dhe atraktive. Partnerët kryesorë përfshijnë shkolla fillore dhe të mesme, Shkollën e Muzikës “Tefta Tashko”, Arkivin Ndërkomunal, Fondacionin Dhemetra, Universitetin e Prishtinës, rrjete muzeale lokale dhe ballkanike, si dhe studiues, artistë dhe aktivistë të ndryshëm.

Pritshmëritë:

- Forcimi i bashkëpunimit profesional dhe i partneriteteve strategjike;
- Shtimi i vizibilitetit, qasjes gjithëpërfshirëse dhe numrit të vizitorëve;
- Botimi dhe shpërndarja e të dhënave për hulumtime dhe projekte edukative;
- Rritja e kapaciteteve të qëndrueshmërisë institucionale

Qëndrueshmëria

Rreziqet dhe tejkalimi i tyre – 2026

Implementimi i objektivave për vitin 2026 mund të ndikohen nga mungesa e një objekti adekuat për veprimtarinë muzeale dhe rreziqet e mundshme natyrore, si përmbytjet, të cilat mund të kërcënojnë ruajtjen e koleksioneve. Për tejkalimin e këtyre sfidave, muzeu do të kërkojë forma alternative për sigurimin e hapësirave dhe do të zhvillojë plane emergjente për mbrojtjen e materialeve muzeale, duke minimizuar çdo rrezik për koleksionet dhe vazhdimësinë e veprimtarisë.

Plan i Punës për Veprimtarinë Muzeale – 2026

Ky plan për vitin 2026 fokusohet në konsolidimin e mëtejshëm institucional të Muzeut të Mitrovicës, përf forcimin e punës arkivore dhe konservuese, zhvillimin e programeve edukative komunitare, realizimin e hulumtimeve tematike, prezantimin e koleksioneve për publikun dhe rritjen e vizibilitetit në përputhje me standardet profesionale dhe legjislacionin në fuqi.

Objektivat Kryesore për vitin 2026

- Përmirësimi i menaxhimit, sistemimit dhe digjitalizimit të arkivave dhe koleksioneve muzeale;
- Zhvillimi dhe miratimi i Programit Edukativ Komunitar për të gjithë grupmoshat dhe grupet e marginalizuara;
- Mbledhja dhe dokumentimi i artefakteve dhe memories kolektive të qytetit;
- Realizimi i ekspozitave tematike dhe aktiviteteve publike, duke përfshirë koleksione të veçanta si enët etnologjike dhe punimet dore të grave;
- Forcimi i partneriteteve me institucione kulturore, akademike dhe shoqërinë civile;
- Rritja e vizibilitetit dhe numrit të vizitorëve.

Projektet dhe Aktivitetet Kryesore – 2026

- Vazhdimi i punës së brendshme muzeale dhe punës arkivore gjatë gjithë vitit;
- Ri-inventarizimi, konservimi dhe digjitalizimi i pjesës prioritare të koleksioneve, duke përfshirë punimet etnologjike dhe artefaktet organike;
- Mbledhja e memories kolektive përmes intervistave, dokumentimit vizual dhe hulumtimeve tematike për Ekzodin dhe Sportin;
- Realizimi i ekspozitave tematike, përfshirë:
 - Ekspozitën e Enëve (koleksion unik etnologjik, disa shekullore)
 - Ekspozitën “Vegëzame” (punime dore të grave të grupit “Vegëza”)
- Zhvillimi i aktiviteteve edukative me shkolla, OJQ dhe komunitete të ndryshme;
- Promovimi i muzeut dhe veprimtarive përmes mediave, rrjeteve sociale dhe botimeve të katalogëve.

Afati Kohor

Të gjitha aktivitetet do të zbatohen gjatë periudhës Janar–Dhjetor 2026, me monitorim dhe raportim periodik.

Buxheti Orientues

Buxheti për vitin 2026 do të sigurohet nga burime komunale, MKRS dhe projekte/donatorë, me fokus në punën arkivore, konservimin e koleksioneve, programet edukative dhe realizimin e ekspozitave.

Teatri i Qytetit “Muharrem Qena”

Ky plan–program paraqet aktivitetin e Teatrit “Muharrem Qena” – Mitrovicë për vitin 2026, me qëllim realizimin e një shfaqjeje teatrale për publikun e rritur, në përputhje me mundësitë buxhetore dhe objektivat institucionale.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica– Municipality of Mitrovica
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport



Plani i Aktivitetit

Gjatë muajve shkurt dhe mars të vitit 2026 parashihet realizimi i një shfaqjeje teatrale për të rritur, me premierë dhe repriza brenda dhe jashtë qytetit të Mitrovicës, duke kontribuar në zhvillimin e jetës kulturore dhe teatrale.

Buxheti i Projektit

Buxheti total i paraparë për realizimin e këtij projekti është 24,900 €, i ndarë si në vijim:

I. Investim në realizimin e shfaqjes – 21,000 €

- Regjisor
- Skenograf dhe skenografi
- Kostumografe dhe kostume
- Mundësi angazhimi të aktorëve nga jashtë institucionit (nese ka nevoj)
- Rekuzita
- Muzika
- Marketing dhe promovim

(të gjitha keto shpenzime për këto kontrata janë të diskutueshme me personat profesional që do të angazhohen, pasi që në fushën e teatrit nuk ka çmime fikse por bisedohen mes të angazhuarve dhe menagjmentit të teatrit, pra ky është plan i diskutueshem kur të vie koha në praktikë)

II. Shpenzime për udhëtime dhe nevoja gjatë reprizave – 3,900 €

Përfundim

Zbatimi i këtij plan–programi synon ngritjen e cilësisë artistike të produksioneve teatrale, rritjen e interesimit të publikut dhe përfaqësimin dinjitoz të Teatrit “Muharrem Qena” – Mitrovicë në nivel lokal dhe më gjerë.

Me shpresën se do të na mbështetni edhe ju si Komunë (DKRS), ne planifikojmë që gjatë vitit të realizojmë edhe 2-3 shfaqje të tjera, ku njëra prej tyre të jetë për fëmijë, duke e pasuruar repertorin dhe aktivitetin kulturor për të gjitha grupmoshat në komunë.



SEKTORI PËR RINI

Sektori i Rinisë, i cili vepron në kuadër të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka si mision: fuqizimin e të rinjve dhe krijimin e mjedisit përkrahës për zhvillimin shoqëror dhe personal të tyre, krijimin e mundësive për promovim, zhvillim dhe pjesëmarrje të të rinjve në jetën aktive shoqërore si dhe ofrimin e shërbimeve të barabarta për të rinjtë, që mundësojnë zhvillimin e shkathtësive jetësore dhe vlerave shoqërore, duke respektuar veçoritë individuale tek të rinjtë. Sektori i Rinisë ka për objektiv që të avancojë proceset të cilat ndërlidhen me rolin e të rinjve në komunë dhe fuqizimin e tyre.

Politikat e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, konkretisht të Sektorit të Rinisë së Komunës së Mitrovicës së Jugut, janë:

- Avancimi i infrastrukturës rinore;
- Pjesëmarrja aktive e rinisë në proceset shoqërore;
- Krijimi i mundësive dhe përkrahja e punësimit të rinjve;
- Edukimi dhe parandalimi i dukurive të dëmshme për rininë;
- Fuqizimi dhe qëndrueshmëria e Qendrave Rinore dhe Këshillit Rinor Lokal (KRL);
- Promovimi i Vullnetarizmit;
- Integrimi i grupeve të marginalizuara;
- Infrastruktura Rinore.

Objektivat e Sektorit të Rinisë janë:

- **Plani Rinor Lokal**
Hartimi i Planit Rinor Lokal 2026-2029
- **Konsolidimi, funksionalizimi dhe fuqizimi i Organizatave Rinore**
Ngritja e kapaciteteve për Organizatat Rinore lidhur me zhvillimin organizativ;
Mbështetja e projekteve ose nismave për aktivizimin rinor në komunitet, mobilitetin rinor;
Përkrahja e Organizatave Rinore që promovojnë, ndërgjegjësojnë për të drejtat dhe përgjegjësitë e të rinjve.
- **Përkrahja dhe fuqizimi i Qendrës Rinore dhe KRL-se**
Përkrahja e Qendrës Rinore në programin vjetor për vitin 2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica– Municipality of Mitrovica
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport



Përkrahja e KRL-se ne programin vjetor për vitin 2026

- **Përkrahja për mobilitetin rinor**

Ndërgjegjësimi i komunitetit rinor për pjesëmarrje dhe qytetari aktive

Inventarizimi, përditësimi dhe katalogizimi i shërbimeve të Organizatave Rinore që ofrohen për të rinjtë

- **Zhvillimi i vullnetarizmit**

Promovimi i vullnetarizmit dhe i punës vullnetare

Shënimi i ditës ndërkombëtare të vullnetarizmit

Përkrahja e Organizatave Rinore që promovojnë vullnetarizmin dhe punën vullnetare

- **Zhvillimi i edukimit joformal**

Organizimi dhe mbështetja e ngjarjeve me qëllim aftësimin e të rinjve përmes edukimit joformal

Organizimin e ngjarjeve për promovimin e edukimit jo formal

- **Ofrimi dhe promovimi i mundësive për kyçe në tregun e punës**

Promovimi dhe ndërgjegjësimi i rinisë për orientim në karrierë dhe tregun adekuat të punës

Përkrahja e Organizatave Rinore që merren me këshillim dhe orientim në karrierë, shkathësim dhe ndërmjetësim të rinisë me tregune punës

Përkrahja e nismave kreative për themelimin e bizneseve /ndërmarrësve të reja të të rinjve

- **Promovimi i mënyrës së shëndetshme të jetesës dhe mirëqenies së të rinjve**

Organizimi i ngjarjeve ndërgjegjësuere për dukuritë negative që cenojnë shëndetin e rinisë

- **Përkrahja e Organizatave Rinore që merren me promovimin e mjedisit të shëndetshëm,**

Që përmes fushatave, trajnimeve, punëtorive, debateve dhe aktiviteteve të tjera promovojnë mënyrën e shëndetshme të jetesës tek të rinjtë, duke përfshirë ushqimin e shëndetshëm, shëndetin mendor, parandalimin e dhunës psikike dhe fizike,

Përdorimin e substancave të dëmshme, marrjen me aktivitete fizike etj

Promovimi dhe ndërgjegjësimi i rinisë për dukuritë që cenojnë shëndetin

- **Rritja e sigurisë së rinisë**

Përkrahja e Organizatave Rinore që merren me ndërgjegjësimin për mjedis të sigurt

Ndërgjegjësimi i rinisë për dukuritë negative shoqërore si trafikimi, ekstremizmi, kriminaliteti, bullizmi etj

- **Integrimi i të rinjve në jetën shoqërore për mes aktiviteteve të ndryshme kulturore, sportive dhe rekreative**

Integrimi shoqëror i të rinjve për mes kulturës, sportit dhe rekreacionit



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica– Municipality of Mitrovica
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport



Organizimi i aktiviteteve tradicionale për të rinjtë, (Java e Rinise, Dita Ndërkombëtare e Rinise, Dita ndërkombëtare e Vullnetarizmit) .

Po ashtu ne kuadër te sektorit te rinisë ka ekzistuar edhe Qendra Rinore ne Mitrovicë, ku do ta rifunksjionalizojmë Qendren Rinore ne Mitrovice gjithashtu kemi bashkëpunim dhe partneritet me DiakoniaYouthCenter që janë hapësira të funksionalizuara për zhvillimin e aktiviteteve të rinjve. Poashtu edhe qendra inovative ne bashkepunim me REA Mitrovica Inovative hub.

Disa nga aktivitetet që Sektori i Rinisë tradicionalisht organizon, dhe që planifikon t'i organizojë edhe këtë vit janë:

- Aktivitete të ndryshme rinore për Ditën e Pranverës, 21 mars
- Aktivitete të ndryshme rinore për 31 Majin Ditën Ndërkombëtare kundër Duhanit
- Aktivitete të ndryshme rinore për Ditën ndërkombëtare të Librit, 23 prill
- Aktivitetet të ndryshme rinore për 26 Qershorin Ditën ndërkombëtare kundër narkotikëve
- Aktivitete të ndryshme rekreative kulturore e shkencore gjate muajve të diasporës
- Aktivitete të ndryshme rinore për Ditën ndërkombëtare të rinisë 12 gusht
- Aktivitete të ndryshme rinore për shënimin e Javës së Rinisë shtator
- Aktivitete të ndryshme rinore për shënimin e 1 dhjetorit ditës ndërkombëtare kundër HIV/AIDS
- Aktivitete të ndryshme rinore për shënimin e 5 dhjetorit ditës ndërkombëtare të vullnetarizmit
- Kuvendi Vjetor i KRL-se
- Konferenca rinore
- Hartimi i Planit Rinor Lokal
- Organizimi i punëtorive nëpër shkollat e Mitrovicës me temat: Vullnetarizmi, Bullizmi dhe Qytetaria Aktive

SEKTORI I SPORTIT

Sektori i Sportit në kuadër të DKRS-së, aktivitetin e vetë gjatë vitit 2026 do ta bazon në LIGJIN E SPORTIT Nr.2003/24, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe UDHËZIMEVE ADMINISTRATIVE 01/2005 dhe 05/2005, të dala nga Ligji i Sportit , të miratuara nga MKRS dhe ÇJ dhe mbështetur ne Planin dhe programin e punës për vitin 2026.

Megjithate nuk do të mungojnë edhe punët dhe detyrat të cilat nuk kan mundësi të planifikohen në Planin dhe programin e punës por që në ndërkohë paraqiten gjatë vitit 2026.

Prioritet i veçant edhe gjatë këtij viti do ti ipet gjithsesi krijimit të kushteve për punë dhe aktivitet normal të klubeve sportive dhe masovizimit të sportit por gjithësesi duke mos i lënë anash as aktivitetet tradicionale në kuadër të Sektorit të Sportit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica– Municipality of Mitrovica
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport



Shtyllat kryesore të aktivitetit në të cilat do të mbështetet Plani dhe programi i punës për vitin 2026 do të jenë:

- Sporti cilësor-Subvencionimi i klubeve, shoqatave sportive
- Masovizimi i sportit
- Strategjia e sportit
- Organizimi dhe mbajtja e turnireve tradicionale sportive
- Lojrat tradicionale fshatare sportive
- Infrastruktura sportive
- Vizita objekteve sportive
- Takimi me klubet sportive
- Identifikimi dhe monitorimi i aktiviteteve të klubeve sportive
- Mbështetja e projekteve
- Puna administrative
- Manifestimi “ Sportisti i vitit 2026 “dhe çmimi “Lah Nimani”

2 . MASOVIZIMI I SPORTIT


- 2.1 Garat Shkollore Sportive me nxënës të Shkollave Fillore dhe të mesme të organizuara në bashkëpunim me” Shoqatën e pedagogëve dhe arësimitarëve të kulturës fizike dhe sportit shkollor”

3 . ORGANIZIMI DHE MBAJTJA E TURNIREVE TRADICIONALE SPORTIVE

- 3.1 Turnir ne futboll për 17 shkurtin për ditën e pavarësisë
3.2 Liga e Veteranëve – futsall
3.3 Komandant Shemsi Ahmeti- SHEMAI turnir ne futboll te vogël
3.4 Turniri kushtuar Erion Kajtaçit turnir ne futboll te madh
3.5 Turniri N’shesh Mirë se vini Diasporë
3.6 Panairi i sportit- me klube sportive
3.7 Turniri ne futboll U-15 dhe U- 17
3.8 Turniri regjional me kategoria te reja ne futboll
3.9 Lojërat tradicionale fshatare sportive
3.10 Turniri për 28 nëntorin ditën e pavarësisë se Shqipërisë
3.11 Turniri për fund vit U-19
3.12 Turnir ne futboll për Heroin e Kosovës “ Meh Uka “
3.13 Stritboll



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica– Municipality of Mitrovica
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport



4. INFRASTRUKTURA SPORTIVE

Do të punohet dhe vepohet në mirëmbajtjen e objekteve ekzistuese sportive dhe në ngritjen e kapaciteteve ekzistuese.

5. VIZITA OBJEKTEVE SPORTIVE

Si çdo vit edhe këtë vit do të punohet dhe do të behën vizita të rregullta objekteve sportive.

6. TAKIME ME KLUBET SPORTIVE

Në kuadër të vitit planifikohen disa takime të rregullta me klubet sportive me qëllim të përcjelljes së punës dhe monitorimit të aktiviteteve të tyre sportive.

7. IDENTIFIKIMI DHE MONITORIMI I AKTIVITETEVE TË KL. SPORTIVE

Gjithsesi aktivitet me rendësi në punën gjatë vitit 2026 paraqet edhe identifikimi dhe monitorimi i aktiviteteve të klubeve sportive.

8. MBËSHTETJA E PROJEKTEVE

Përveç mbështetjes së klubeve përmes subvencioneve planifikohet edhe mbështetja e projekteve eventuale dhe me interes për DKRS.

9. PUNA ADMINISTRATIVE

Do të behet në mënyrë permanente pranimin dhe përpunimi i lendeve si dhe sistemimi dhe arkivimi i tyre.

10. CEREMONIA “SHPLLJA E SPORTISTIT TË VITIT” Çmimi “Lah Nimani”



Drejtör i drejtorisë
Gazmend Asllani